

U D H Ë Z I M
Nr.24 Datë, 18.04.2001

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË LISTAVE TË
ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të pikës 5 të nenit 58 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

U D H Ë Z O N :

Vënien në dispozicion të listave të zgjedhësve partive politike dhe subjekteve të tjera zgjedhore si vijon:

1.Listat paraprake te zgjedhësve

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të qershorit 2001, partive politike, me kërkesën e tyre, iu vihet në dispozicion një kopje e listës paraprake të zgjedhësve kundrejt pagesës së kostos së prodhimit. Bashklidhur kërkesës, duhet të jetë edhe urdhërpagesa e konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë, për xhirimin në favor të KQZ-së të shumës përkatëse të mandatpagesës së lëshuar nga Drejtori i Regjistrat Kombëtar të Zgjedhësve.

Partita Socialiste dhe Partia Demokratike mund ta tërheqin kopjen e listës paraprake, sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, brenda datës 25.4.2001.

2.Listat përfundimtare të zgjedhësve

Lista përfundimtare e zgjedhësve, e miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhjeve u vihet në dispozicion subjekteve zgjedhore, kundrejt kërkesës me shkrim të organit drejtues të partisë në qendër dhe urdhërpageses së konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë, për likuidimin e 100 % të kostos së prodhimit të listës, brenda dy ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi